

Vaksinat e detyrueshme të COVID-19 për studentët atletë | Pyetje të bëra shpesh

Për pjesën e mbetur të vitit shkollor 2021-2022, rrethi shkollor u kërkon të gjithë studentëve atletë që të vaksinohen plotësisht me vaksinën e COVID-19 që të marrin pjesë në aktivitetet sportive të shkollës. Më poshtë mund të shihni një listë të pyetjeve të bëra shpesh (FAQ) si referencë.

Pse po kërkohen vakcina për atletët studentë të rrethit shkollor që marrin pjesë në aktivitetet sportive të shkollës?

Rastet pozitive me COVID-19 të atletëve që marrin pjesë në programet sportive të rrethit shkollor bëjnë që një numër i madh i studentëve të ndërpresin pjesëmarrjen në atletikë, dhe më e rëndësishmja, mësimin në klasë. Vendimi për t'u kërkuar të gjithë studentëve atletë që marrin pjesë në aktivitete sportive të shkollës që të vaksinohen është marrë duke treguar merak të madh për shëndetin dhe sigurinë e të gjithëve dhe për bashkëveprimet e veçanta që kërkon sporti mes studentëve, duke përfshirë kontaktin nga afër dhe të rregullt gjatë stërvitjeve dhe kompeticioneve, gjatë udhëtimeve në grup dhe gjatë bashkëveprimeve me studentët nga institucione të tjera në mjedise konkurruese me nivel të lartë kontakti. Si pasojë, studentëve atletë që duan të marrin pjesë në programet e atletikës së shkollës për pjesën e mbetur të vitit shkollor 2021-2022 u kërkohet që të vaksinohen kundër COVID-19.

Kur duhet ta bëj vaksinën e COVID-19 që të jem gati për sezonin sportiv të dimrit dhe pranverës?

Studentëve atletë që marrin pjesë në sezonin sportiv të dimrit do t'u kërkohet që të jenë të vaksinuar plotësisht para datës 18 dhjetor 2021 që të marrin pjesë në sportin e tyre në fillim të sezonit. Studentët atletë që marrin pjesë në sportet e pranverës duhet të jenë të vaksinuar plotësisht para datës 1 mars 2022.

Sezoni	Sportet	Afati për vaksinimin e plotë	Merr dozën e parë Doza nga	Merr dozën e dytë para
Dimër	Basketboll, Bouling, Kërcimtare tifoze, Vrapim brenda, Noti, Mundje	18 dhjetor 2021	13 nëntor 2021	4 dhjetor 2021
Pranverë	Badmington, Bejzboll, Lakrose, Softboll, Tenis, Gara në pistë dhe Volejbol	1 mars 2022	25 janar 2022	15 shkurt 2022

Kur mund të vaksinohem nëse nuk kam bërë asnjë ose të dyja dozat e vaksinës?

Vaksinat mund të bëhen në shumë pika në Filadelfia. Të gjithë studentët mund të bëjnë vaksinën për COVID-19 në eventet e vaksinimit në shkollat e rrethit në partneritet me një ofrues vaksinimi, në farmaci, në qendrat shëndetësore të qytetit ose te ofruesit e kujdesit shëndetësor kryesor.

Eventet e ardhshme të vaksinimit të sponsorizuara nga rrethi shkollor mund të gjenden në www.philasd.org/studenthealth. Eventet e vaksinimit të sponsorizuara nga departamenti shëndetësor i qytetit mund të gjenden [KËTU](#).

Si të tregoj provë të vaksinimit?

Atletët duhet të paraqesin një kopje të kartës së vaksinës së tyre në shkollë, e cila do të regjistrohet te Sistemi i Informacionit të Studentit (SIS). Sistemi i Informacionit të Studentit është një sistem i sigurt që përdoret nga rrethi shkollor për të mbrojtur informacionet shëndetësore të studentit. Statusi i vaksinimit do të përdoret për të përcaktuar se kush ka nevojë dhe kush nuk ka nevojë për karantinë nëse ndodh një rast pozitiv me COVID-19 te një student ose pjesëtar i stafit.

Po nëse nuk arrij të vaksinohem para datës 18 dhjetor?

Studentët që nuk janë vaksinuar plotësisht para datës 18 dhjetor nuk do të pranohen që të luajnë derisa t'i tregojnë shkollës vërtetim se janë vaksinuar plotësisht.

A i pranon rrethi shkollor përjashtimet ndaj kërkesës për vaksinim për studentët atletë?

Po. Përjashtimet ndaj kërkesës për t'u vaksinuar për COVID-19 mund të jepen për arsye të verifikueshme mjekësore ose fetare dhe mund të kërkohen duke plotësuar [Formularin për Përjashtimin nga Vaksinimi](#). Formularët për përjashtimin nga vaksinimi duhet t'i paraqiten direkt infermierit të shkollës. Kërkesa për përjashtim duhet të plotësohet të paktën 7 ditë para fillimit të sezonit.

Çfarë do të ndodhë nëse nuk kam vërtetim të vaksinimit kur fillon sezoni im sportiv?

Studentët atletë që nuk janë vaksinuar ose që nuk paraqesin vërtetim të përshtatshëm për vaksinimin para afatit të kërkuar, ose që nuk kanë paraqitur një formular për përjashtim nga vaksinimi do të hiqen nga lista e skuadrës së tyre dhe do të humbasin të gjitha privilegjet që u jepen studentëve atletë, duke përfshirë stërvitjen në skuadër ose atë individuale, kompeticionet dhe çdo objekt sportiv derisa të tregojnë vërtetim të vaksinimit të plotë.

A do t'u kërkohet atletëve të shkollës së mesme që marrin pjesë në aktivitetet sportive të shkollës që të bëjnë vaksinën për COVID-19?

Po. Atletëve e shkollës së mesme që marrin pjesë në aktivitetet sportive të shkollës do t'u kërkohet që të marrin dozën e parë të vaksinës të paktën 45 ditë pas aprovimit për studentët e moshës 5-11 vjeç. Më pas, doza e dytë do të kërkohet 21 ditë pas dozës së parë.

Unë mbush 12 vjeç pasi fillon sezoni sportiv. Sa kohë kam që të vaksinohem plotësisht?

Studentët që sapo janë pranuar për vaksinim do të kenë 45 ditë kohë pasi të bëhen 12 vjeç që të bëjnë dozën e parë, dhe më pas duhet ta bëjnë dozën e dytë jo më vonë se 8 javë pasi kanë mbushur 12 vjeç.

Sa kushton vakcina për COVID-19?

Vaksina për COVID-19 është falas, pavarësisht siguracionit apo statusit të emigracionit.

A i përmbushin kërkesat të gjitha vaksinat për COVID-19 (Moderna, Pfizer, Johnson & Johnson)?

Aktualisht, vakcina e Pfizer është e vetmja në dispozicion të studentëve nën moshën 18 vjeç. Studentët e moshës 18 vjeç e sipër mund të bëjnë vaksinat Johnson & Johnson, Moderna ose Pfizer që të përmbushin kërkesat.

A është e nevojshme që ta mbaj gjithnjë me vete kartën e vaksinimit?

Jo. Studentët duhet t'ia tregojnë vërtetimin e vaksinimit shkollës së tyre. Pasi të jetë dhënë vërtetimi, studentëve nuk u kërkohet më që ta mbajnë me vete kartën e vaksinimit.

A do të ndryshojë kjo kërkesë kërkesat për të bërë testin çdo javë?

Studentët atletë që janë të vaksinuar nuk ka nevojë të bëjnë testin dy herë në javë për COVID-19. Studentët duhet të vazhdojnë ta bëjnë testin deri në 2 javë pas dozës së dytë të vaksinës.

Studentët që paraqesin një formular përjashtimi do të testohen dy herë në javë për COVID-19.

Edhe nëse janë vaksinuar, kushdo që ka simptoma të ngjashme me ato të COVID-19 duhet të bëjë testi për COVID-19 dhe të izolohet nëse del pozitiv.

Nëse kam qenë më parë me COVID-19 dhe jam shëruar, a është e nevojshme që të vaksinohem?

Po, studentët atletë që kanë pasur tashmë COVID-19 do të kenë ende nevojë të bëjnë vaksinën për COVID-19 dhe të japin vërtetim të vaksinimit. Studimet nuk kanë treguar ende se për sa kohë është i mbrojtur dikush nga COVID-19 pasi ka qenë i infektuar. Vaksinimi ndihmon në parandalimin e një infeksioni tjetër. Për këtë arsye, atletëve studentë u kërkohet që të vaksinohen edhe nëse kanë qenë më parë të infektuar.

A u kërkohet trajnerëve dhe stafit të atletikës që të vaksinohen?

Po. Trajnerëve dhe stafit të atletikës u kërkohet që të vaksinohen si pjesë e rregullores së rrethit shkollor.

A është e nevojshme që studentët që shkojnë në shkollat çarter dhe që nuk marrin pjesë në aktivitetet sportive të rrethit shkollor që të vaksinohen?

Jo. Kjo kërkesë nuk vlen për studentët që shkojnë në shkollat çarter dhe që marrin pjesë në programet e atletikës vetëm si anëtarë të skuadrave të shkollës çarter të tyre.

A u kërkohet studentëve që shkojnë në Shkollat Çarter, Cyber ose Shtëpi dhe që luajnë në një skuadër sportive të rrethit shkollor që të zbatojnë kërkesën për atletët studentë të rrethit shkollor?

Po. Të gjithë studentëve atletë në skuadrat e rrethit shkollor u kërkohet të vaksinohen plotësisht. Ju lutemi t'ia tregoni vërtetimin e vaksinimit për COVID-19 direkt trajnerit tuaj.

Studentëve që pranohen për përjashtime mbi bazën e arsyeve mjekësore ose fetare do t'u kërkohet që të bëjnë testin për COVID-19 dy herë në javë.

Çfarë do të thonë fjalët i pavaksinuar, i vaksinuar pjesërisht dhe i vaksinuar plotësisht për COVID-19?

I pavaksinuar: Një person që nuk ka marrë asnjë dozë të vaksinës për COVID-19.

I vaksinuar pjesërisht: Një person që ka marrë një dozë ose që ka marrë dozën e dytë, por nuk kanë kaluar ende 14 ditë nga doza e parë. Për këtë kërkesë, ky person duhet t'u bindet kërkesave që vlejnjë për një person të pavaksinuar.

I vaksinuar plotësisht: Një person që ka marrë dozën e dytë të një serie vaksinimi me 2 doza dhe kanë kaluar 14 ditë që prej asaj doze të dytë ose një dozë të një vaccine me 1 dozë për COVID-19 dhe kanë kaluar 14 ditë që prej asaj doze.

Studentëve që janë të vaksinuar plotësisht do t'u kërkohet ende që të ndjekin strategjitë e tjera për lehtësimin e situatës së COVID-19, si mbajtja e maskave, larja e duarve dhe distancimi social.

Si po përgjigjen kolegjet dhe universitetet ndaj kërkesave për vaksinimin?

Vaksinimi për COVID-19 për studentët atletë rrit në maksimum shëndetin dhe sigurinë e të gjithë skuadrës dhe bën që sezonet sportive të jenë të sigurta e të suksesshme duke minimizuar ndikimin që kanë anulimi i stërvitjeve, lojërave dhe sezoneve.

Sipas publikimeve të fundit, 25 kolegjet dhe universitetet më të mira të vendit u kanë kërkuar studentëve që të vaksinohen plotësisht para se të shkelin në kampus. Lista e të gjitha kolegjeve dhe universiteteve të Shteteve të Bashkuara që kërkojnë vaksinim për COVID-19 mund të gjendet [KËTU](#)

Me kë mund të flas nëse kam pyetje ose shqetësime?

Një ofrues i kujdesit shëndetësor ose një infermier i shkollës mund të japë informacion të mëtejshëm për vaksinën.